

Ndryshimet në SNRF 1

Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
dhe

SNK 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale

**Kostoja e një investimi në një filial, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara ose
pjesëmarrje**

Ndryshimet në SNRF 1 *Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*

Njohja dhe matja

Përfashtimet nga SNRF-të e tjera

- 13 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një ose më shumë prej përjashtimeve të mëposhtme:
- (a) ...
 - (ea) investimet në filiale, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara dhe pjesëmarrjet (paragrafët 23A dhe 23B);
 - (f) ...

Investimet në filiale, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara dhe pjesëmarrjet

- 23A Kur një njësi ekonomike përgatit pasqyrat financiare individuale, SNK 27 *Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale* kërkon të kontabilizohen investimet e njësisë ekonomike në filiale, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara dhe pjesëmarrjet ose :
- (a) me kosto ose
 - (b) në përputhje me SNK 39 *Instrumentet financiare : Njohja dhe matja*.
- 23B Nëse një zbatues për herë të parë i standardeve e mat një investim të tillë me kosto në përputhje me paragrafin 23A(a), do ta matë këtë investim me një nga shumat e mëposhtme në çelje të pasqyrës së pozicionit financiar individual sipas SNRF:
- (a) koston e përcaktuar në përputhje me SNK 27 ose
 - (b) koston e supozuar. Kostoja e supozuar e një investimi të tillë do të jetë:
 - (i) vlera e drejtë e tij (e përcaktuar në përputhje me SNK 39) në pasqyrat financiare individuale në datën e kalimit të njësisë ekonomike në SNRF-të ose
 - (ii) vlera kontabël neto e mëparshme sipas PPPK –së në këtë datë.
- Një zbatues për herë të parë mund të zgjedhë (i) ose (ii) më sipër për të matur investimin e tij në secilin filial, njësi ekonomike të bashkëkontrolluar ose pjesëmarrje kur ai vendos që matjen ta bëjë duke përdorur një kosto të supozuar.

Përcaktimi i instrumenteve financiare të njohura më parë

- 25A SNK 39 lejon...

Përjashtimet për zbatimin në retrospektivë të SNRF-ve të tjera

Interesat jokontrolluese

- 34C Një zbatues për herë të parë do të zbatojë kërkesat e SNK 27 (i ndryshuar në 2008)...

Paraqitja dhe dhënia e informacionit shpjegues

Përdorimi i kostos së supozuar për investimet në filiale, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara dhe pjesëmarrjet

- 44A Në mënyrë të ngjashme, nëse një njësi ekonomike përdor një kosto të supozuar në çelje të pasqyrës së pozicionit financiar sipas SNRF-ve për një investim në filial, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara ose pjesëmarrjet në pasqyrat financiare individuale të saj (shih paragrafi 23B), atehere në pasqyrat financiare individuale të njesisë ekonomike, të parat sipas SNRF-ve, do të jepet informacion shpjegues për:
- (a) koston totale të supozuar të këtyre investimeve për të cilat kostoja e supozuar është vlera kontabël neto e mëparshme sipas PPPK-së;
 - (b) koston totale të supozuar të këtyre investimeve për të cilat kostoja e supozuar është vlera e drejtë; dhe
 - (c) rregullimin total në vlerat kontabël neto të raportuara sipas PPPK-së të mëparshëm.

Data e hyrjes në fuqi

- 47K *Kostoja e një investimi në një filial, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara ose pjesëmarrje* (Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 27), publikuar në maj 2008, janë shtuar paragrafët 13(ea), 23A, 23B dhe 44A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këta paragrafë për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi edhe për një periudhë më të hershme. Nëse një njësi ekonomike i zbaton paragrafët për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Ndryshimet në SNK 27 Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale (të ndryshuara prej Përmirësimeve në SNRF-të në maj 2008)

Në paragrafin 4, referenca në 'metodën e kostos' është hequr. Pas paragrafit 38, janë shtuar paragrafët 38A–38C. Pas paragrafit 45A, janë shtuar paragrafët 45B dhe 45C.

Trajtimi kontabël i investimeve në filiale, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara dhe pjesëmarrjet në pasqyrat financiare individuale

38A Një njësi ekonomike do të njohë një dividend nga një filial, njësi ekonomike e bashkëkontrolluar ose pjesëmarrje në fitimin apo humbjen në pasqyrat e saj financiare individuale kur ka lindur e drejta për të marrë dividendin.

38B Kur një mëmë riorganizon strukturën e grupit të saj duke krijuar një njësi ekonomike të re si mëmë të tij në një mënyrë të tillë që plotëson kriteret e mëposhtme:

- (a) mëma e re fiton kontrollin e mëmës së origjinës duke emetuar instrumente kapitali në këmbim të instrumenteve ekzistuese të kapitalit të mëmës së origjinës;
- (b) aktivet dhe pasivet e grupit të ri dhe të grupit të origjinës janë të njëjta menjëherë para dhe pas riorganizimit; dhe
- (c) pronarët e mëmës së origjinës para riorganizimit kanë të njëjtat interesa absolute dhe relative në aktivet neto të grupit të origjinës dhe grupit të ri menjëherë para dhe pas riorganizimit

dhe trajtimi kontabël nga mëma e re të investimeve të saj në njësinë mëmë të origjinës kryhet në përputhje me paragrafin 38(a) në pasqyrat financiare individuale, njësia mëmë e re do të matë koston me vlerën kontabël neto të aksioneve të saj treguar në pasqyrat financiare individuale të mëmës së origjinës në datën e riorganizimit.

38C Në mënyrë të ngjashme, një njësi ekonomike që nuk është mëmë duhet të krijojë një njësi ekonomike të re si mëmën e saj në mënyrë të tillë që të plotësojë kriteret në paragrafin 38B. Kërkesat në paragrafin 38B zbatohen në mënyrë të njëjtë për riorganizime të tilla. Në këto raste, referencat në lidhje me 'mëmën e origjinës' dhe 'grupin e origjinës' i përkasin 'njësisë ekonomike të origjinës'.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

45B *Kostoja e një investimi në një filial, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara ose pjesëmarrje* (Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 27), publikuar në maj 2008, është hequr përkufizimi i metodës së kostos nga paragrafi 4 dhe është shtuar paragrafi 38A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime në mënyrë

prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi edhe për një periudhë më të hershme. Nëse një njësi ekonomike i zbaton paragrafët për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë në të njëjtën kohë ndryshimet e lidhura me SNK 18, SNK 21 dhe SNK 36.

- 45C *Kostoja e një investimi në një filial, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara ose pjesëmarrje* (Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 27), publikuar në maj 2008, janë shtuar 38B dhe 38C. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për riorganizimet e ndodhura në periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi edhe për një periudhë më të hershme. Për më tepër, një njësi ekonomike mund të zgjedhë të zbatojë paragrafët 38B dhe 38C në mënyrë retrospektive për riorganizimet e kaluara brenda objektit të këtyre paragrafëve. Megjithatë, nëse një njësi ekonomike riparaqet çdo riorganizim në përputhje me paragrafin 38B ose 38C, ajo duhet të riparaqesë të gjitha riorganizimet më të fundit brenda objektit të këtyre paragrafëve. Nëse një njësi ekonomike i zbaton paragrafët 38B dhe 38C për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Shtojcë

Ndryshimet në SNRF-të e tjera

Njësitë ekonomike do të zbatojnë ndryshimet e mëposhtme në SNK 18, SNK 21 dhe SNK 36 kur ato zbatojnë ndryshimet që lidhen me paragrafët 4 dhe 38A të SNK 27.

SNK 18 Të ardhurat

A1 SNK 18 është ndryshuar siç është përshkruar më poshtë.

Në rubrikë, fjalia e parë është ndryshuar si më poshtë:

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 18 *Të ardhurat* (SNK 18) është parashtruar në paragrafët 1–38. Të gjithë paragrafët ...

Paragrafi 32 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 38 si më poshtë.

32 Kur interesi i papaguar është rritur para blerjes së një investimi që mbart interes, arkëtimi i mëpasshëm i interesit shpërndahet midis periudhave të para-bletjes dhe pas-bletjes; vetëm pjesa e pas-bletjes njihet si e ardhur.

38 *Kostoja e një investimi në një filial, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara ose pjesëmarrje* (Ndryshimet në SNRF 1 *Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar* dhe SNK 27 *Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale*), publikuar në maj 2008, është ndryshuar paragrafi 32. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi edhe për një periudhë më të hershme. Nëse një njësi ekonomike i zbaton ndryshimet që lidhen me paragrafët 4 dhe 38A të SNK 27 për një periudhë më të hershme, ajo do të zbatojë në të njëjtën kohë ndryshimin në paragrafin 32.

SNK 21 Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja

A2 Në SNK 21, paragrafi 49 është ndryshuar si vijon:

49 Një njësi ekonomike mund të heqë dorë plotësisht ose pjesërisht nga interesat e saj në një njësi ekonomike të huaj nëpërmjet shitjes, likuidimit, ripagimit të aksioneve të kapitalit aksionar ose braktisjes së plotë apo të pjesshme të kësaj njësie ekonomike. Një ulje e vlerës kontabël neto të një njësie ekonomike të huaj, qoftë për shkak të humbjeve të veta, qoftë për shkak të një zhvlerësimi të njohur nga një investitor, nuk përbën heqje dorë të pjesshme. Pra, asnjë pjesë e fitimit ose humbjes nga këmbimi i monedhave të huaja, i njohur në fitimin e përgjithshëm, nuk riklasifikohet në fitime dhe humbje në momentin e uljes së vlerës.

SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve

A3 Në SNK 36, pas paragrafit 12(g), janë shtuar një titull dhe nënparagrafi (h). Pas paragrafit 140C, është shtuar paragrafi 140D.

12 Në vlerësimin nëse ka ndonjë tregues që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar, një njësi ekonomike do të marrë parasysh minimalisht treguesit e mëposhtëm:

...

Dividendi nga një filial, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara ose pjesëmarrje

(h) për një investim në një filial, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara ose pjesëmarrje, investitori njih një dividend nga investimi dhe është e disponueshme evidenca që tregon se:

(i) vlera kontabël neto e investimit në pasqyrat financiare individuale e tejkalon vlerën kontabël neto të shumës në pasqyrat financiare të konsoliduara të aktiveve neto të të investuarit, përfshirë edhe emrin e mirë përkatës; ose

(ii) dividendi tejkalon totalin e fitimit të përgjithshëm të filialit, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara ose pjesëmarrjes në periudhën e deklarimit të dividendit.

140D *Kostoja e një investimi në një filial, njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara ose pjesëmarrje* (Ndryshimet në SNRF 1 *Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar* dhe SNK 27), publikuar në maj 2008, është shtuar pragrafi 12(h). Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi edhe për një periudhë më të hershme. Nëse një njësi ekonomike i zbaton ndryshimet përkatëse në paragrafët 4 dhe 38A të SNK 27 për një periudhë më të hershme, ajo do të zbatojë në të njëjtën kohë ndryshimin në paragrafin 12(h).